



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE
ENERGJISË**

Nr. 5374/prot.
2

Tiranë, më 16.7 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.718/1, datë 20.08.2003.

SHOQËRISË "RAKIPI" SHPK

Rruga "Perlat Rexhepi", Ndërtesa 13 katëshe, Kati i II-të, Zyra nr.3, Tiranë

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA**

Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "Rakipi" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.718/1, datë 20.08.2003, për mineral rërë bituminoze, në objektin "Patos", Fier.

Nga struktura përgjegjëse AKBN, me shkresën nr.5796, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.5374, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.718/1, datë 20.08.2003, për mineral rërë bituminoze, në objektin "Patos", Fier, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor për vitin 2016-2017, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Shkresa e AKBN-së ku propozohet revokimi i lejes nr.718/1, datë 20.08.2003, është dërguar për dijeni edhe shoqërisë tuaj, për të cilën keni dërguar përgjigje në datë 07.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.5374/1, datë 07.08.2017, dhe jepni argumentet tuaja për shkaqet për të cilat nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimit për lejen në fjale. Argumentet tuaja i gjejmë të pa mbështetura në legjislacionin që është në fuqi për këtë problem.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.718/1, datë 20.08.2003, për mineral rërë bituminoze, në objektin “Patos”, Fier, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.718, datë 20.08.2003, për mineral rërë bituminoze, në objektin “Patos”, Fier.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

